



A.nr.1816/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi- Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1816/2025, të datës 20.10.2025, të parashtruar nga ankuesi N.B, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Isuf Zejna, nga Prishtina, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike *“kërkesë nga marrëdhënia e punës”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1816/2025, e datës 20.10.2025, e parashtruar nga ankuesi N.B, ashtu që **shfuqizohet** Vendimi me Nr.1920, i datës 14.10.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa lënda kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosje** tek organi i njëjtë.

II. Obligohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken I të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N.B (*tutje referuar* ankuesi), përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 20.10.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6883/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1920, të datës 14.10.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, përmes të cilit akt i njëjti pas përfundimit të dy mandatave në pozitën e kategorisë së lartë drejtuese: Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, është sistemuar në

pozitën e kategorisë së mesme drejtuese: Drejtor i Departamentit të Arkivave Digjitale, në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.11.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa, ky i fundit, më datë 11.11.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendim me numër protokolli 7631/2025, të datës 01.12.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1816/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6883/2025, të datës 20.10.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Autorizimin e datës 17.09.2025; Diplomën me Nr.1019 të datës 21.04.2005; Shkresën e datës 13.01.2000, në gjuhën gjermane; Letër reference, në gjuhën angleze; Certifikatat në gjuhën angleze, për përfundimin e programit të studimeve, trajnimeve dhe kurseve; Dëshminë akademike, në gjuhën angleze; Licencën e punës të datës 04.03.2022; Cv e ankuesit; Diplomën me Nr.prot.103/1989 e datës 15.06.1989; Dëftesat e datës 14.06.1989, 15.06.1988, 09.06.1987 dhe 05.06.1986; Referencën me numër protokolli 05-6381 të datës 25.08.2025; Vendimin me Nr.22/140 të datës 26.04.2023; Vendimin me Nr.02/2025 të datës 18.08.2021; Vendimin me Nr.11/42 të datës 19.04.2018; Vendimin me Nr.23/61 të datës 22.08.2018; Akt emërimit me Nr.156 të datës 31.05.2016; Deklaratën e datës 31.05.2016; Vendimin me 01 Nr.02-7 të datës 02.08.1999; Vendimin me Nr.02/27 të datës 18.08.2021; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 11.11.2025; Vendimin me Nr.1920, të datës 14.10.2025; Formularin e përshkrimit të punës me numër protokolli 01/134-31/25 të datës 10.06.2025; E-mailin e datës 13.10.2025 (DMZP-M.Sh); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-MSH); E-mailin e datës 13.10.2025 (DMZP-ASHAK); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-MINT); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-ZKM); E-mailin e datës 07.10.2025 (DMZP-AME); E-mailin e datës 07.10.2025 (DMZP-MMPHI); E-mailin e datës 07.10.2025 (DMZP-MD); E-mailin e datës 08.10.2025 (DMZP-AKK); E-mailin e datës 08.10.2025 (DMZP-IKKL); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-AKA); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-MAPL); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-MPJD); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-MKK); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-AAAPARr); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-IQP); E-mailin e datës 06.10.2025 (DMZP-AUV); E-mailin e datës 07.10.2025 (DMZP-MZhR); E-mailin e datës 07.10.2025 (DMZP-AMKM); E-mailin e datës 08.10.2025 (DMZP-MBZHR).

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Vendimit me Nr.23/61 të datës 22.08.2018, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është emëruar në pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, me mandat prej tri (3) viteve. Tutje, Qeveria e Republikës së Kosovës mbështetur në nenin

42 dhe 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përmes Vendimit me Nr.02/27 të datës 18.08.2021, i ka ri zgjatur ankuesit mandatin në këtë pozitë të kategorisë së lartë drejtuese edhe për katër (4) vite.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datë 01.10.2025, ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë, konfirmimin se ankuesit përfunduar mandati, duke kërkuar me këtë rast të përcjellët edhe dosja e të njëjtit, në mënyrë që DMZP të ndërmarrë veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemimin e tij.

Ndërsa, U.D Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, përmes e-mailit të datës 02.10.2025, ka konfirmuar se ankuesit mandati në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, i ka përfunduar me datë 18.08.2025, rrjedhimisht ka përcjellë edhe dosjen e të njëjtit.

Si rrjedhojë, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 14.10.2025 ka nxjerrë Vendimin me Nr.1920/2025, përmes të cilit akt ankuesin e ka sistemuar në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese: Drejtor i Departamentit të Arkivave Digjitale, në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.1920/2025 të datës 14.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin se i njëjti akt është i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 1.7 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, ankuesi kërkon nga Këshilli, aprovimin e ankesës, pezullimin e kësaj procedure për sistemimin e tij në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese Drejtor i Departamentit të Arkivave Digjitale, në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, dhe anulimin e aktit kontestues.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin dhe konstatimin e drejtë të pretendimeve ankimore dhe çështjes përkatëse, i 'u referua dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më konkretisht:

-Nenit 13, ku përcaktohet se: *1. Ministria përgjegjëse për administratë publike ka këto përgjegjësi: 1.1. propozon dhe monitoron zbatimin e politikave për paga për zyrtaret/ët publik dhe funksionarët/ët publik; 1.2. mbështet dhe këshillon institucionet në zbatimin e këtij ligji; 1.3. organizon sipas planifikimit procedurat e pranimit për institucionet e administratës shtetërore në pajtim me këtë ligj; 1.4. planifikon, vendos dhe kryen sistemimin e nëpunëseve/ëve civil, të cilat/ët kanë përfunduar mandatin, në pajtim me këtë ligj; 1.5. miraton dhe monitoron zbatimin e programeve të trajnimit për nëpunëset/it civil; 1.6. administron dhe mirëmban Sistemin e Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; 1.7. harton dhe miraton udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit për zyrtaret/ët publik; 1.8. harton politikat e angazhimit të praktikanteve/ëve në administratën publike; 1.9. harton planin e përgjithshëm të personelit; 1.10. përgatit dhe publikon raportin vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore. 2. Ministria përgjegjëse për administratë publike themelon njësi administrative përgjegjëse që ushtron kompetencat e dhëna me këtë ligj.;*

- Nenit 38, paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Pozitat në shërbimin civil grupohen sipas kategorisë, klasës, kualifikimit dhe natyrës së pozitës. 2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoresh/in e përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoresh/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoresh/in e një agjencie*

ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional.

- Nenit 99, paragrafit 4, ku përcaktohet se: *4. Nëpunësja/i civil dhe nëpunësja/i i shërbimit publik i kategorisë së lartë drejtuese, të cilit i është vazhduar mandati sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, konsiderohet se ka përfunduar mandatin e dytë, dhe nuk ka të drejtë t'i vazhdohet mandati edhe njëherë.;* si dhe,

- Nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *Në nenin 99 të ligjit bazik, pas paragrafit 14. shtohet një paragraf i ri 15 si në vijim: 15. Nëpunësit e lartë drejtues që janë emëruar në pozitë para hyrjes në fuqi të ligjit bazik, pas përfundimit të mandatit sistemohen nga njësia përgjegjëse në pozitë të kategorisë së mesme drejtuese. Kur nuk ka pozita të lira në kategorinë e mesme drejtuese, sistemimi bëhet në pozitë të kategorisë profesionale për të cilën nëpunësi i plotëson kriteret.*

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara nga neni 54 paragrafi 1.8 i Rregullores për Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pas marrjes së konfirmimit nga U.D Udhëheqësja e Njësise për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, për përfundimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie, me datë 06.10.2025, ka kërkuar nga institucionet e administratës shtetërore informacion lidhur me pozitat e lira të kategorisë mesme drejtuese.

Ndërlidhur me kërkesën e lartë theksuar të datës 06.10.2025, nga shkresat e lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ka pranuar gjithsejtë nëntëmbëdhjetë (19) përgjigje nga institucionet përkatëse të Administratës Shtetërore, përkatësisht këto përgjigje si në vijim:

- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Ministria e Shëndetësisë;
- përgjigjen e datës 13.10.2025 nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Zyra e Kryeministrit;
- përgjigjen e datës 07.10.2025 nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent;
- përgjigjen e datës 07.10.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- përgjigjen e datës 07.10.2025 nga Ministria e Drejtësisë;
- përgjigjen e datës 08.10.2025 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës;
- përgjigjen e datës 08.10.2025 nga Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Agjencia e Kosovës për Akreditimi;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Ministria për Komunitete dhe Kthim;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur;

- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Inspektorati Qendrorë i Punës;
- përgjigjen e datës 06.10.2025 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- përgjigjen e datës 07.10.2025 nga Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- përgjigjen e datës 07.10.2025 nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale; si dhe,
- përgjigjen e datës 08.10.2025 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ndërsa, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i aktit kontestues me ankesë konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në të njëjtin akt ka ofruar arsyetim vetëm lidhur me përgjigjet e dy institucioneve, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë si dhe të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, duke theksuar më shumë se me datë 06.10.2025 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, kemi pranuar njoftimin lidhur me një pozitë të lirë të kategorisë së mesme drejtuese-Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor, për të cilën fusha e kërkuar e arsimit kërkohet: Shkenca kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inxhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji informative, Inxhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion, e për të cilën pozitë ka theksuar se nuk përshtatet me kualifikimin arsimor të z.B, dhe duke marrë parasysh këtë më tej është theksuar se DMZP-ja ka kërkuar informacion nga institucionet e Administratës Shtetërore informacion lidhur me pozitën e lira të kategorisë së mesme drejtuese, dhe se me datë 13.10.2025 Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar, ka njoftuar se në këtë institucion është e lirë pozita e kategorisë së mesme drejtuese-Drejtor i Departamentit të Arkivave Digjitale, për të cilën fusha e kërkuar e arsimit është e paspecifikuar, pozitë të cilën edhe e ka sistemuar ankuesin.

Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë arsyetimin e lartë theksuar, përkatësisht atë se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ka pranuar gjithsejtë nëntëmbëdhjetë (19) përgjigje nga institucionet përkatëse të Administratës Shtetërore, ndërsa, në arsyetimin e aktit kontestues ka ofruar sqarime vetëm për 2 (dy) prej tyre këtyre përgjigjeve, nga rrjedhë se Vendimi me Nr.1920/2025 i datës 14.10.2025, për nga përmbajtja dhe arsyetimi nuk ka mbështetje në dispozitat e nenit 48 paragrafit 1 nën paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ngase përmes këtij vendimi rezulton se nuk është shpjeguar qartë dhe plotësisht gjendja faktike apo ofrimi i sqarimit të mundësisë apo jo të sistemimit të ankuesit në pozitë dhe institucion tjetër që kanë ofruar përgjigjet përkatëse sikurse u theksua më lartë, si dhe se nuk janë administruar asnjë nga provat të cilat kanë qenë vendimtare gjatë kësaj vendimmarrje. Rrjedhimisht, arsyetimi i vendimit nuk përmban përshkrimin rreth përshtatshmërisë së ankuesit për pozitën përkatëse si dhe për pozitën tjetër të dërguar nga institucionet tjera e të cilat siç u theksua më lartë nuk janë elaboruar fare, andaj në vlerësimin e Kolegjit kjo do t'i siguronte palës mundësinë që ta kuptonte me qartë aktin administrativ. Po ashtu, vendimi i kontestuar nuk përmban një shpjegim të gjendjes faktike, nëse në kohën e nxjerrjes së vendimit për sistemimin e ankuesit kanë qenë vetëm këto dy pozita të lira, përkatësisht pozita e Drejtorit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe pozita e Drejtorit të Departamentit të Arkivave Digjitale në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, apo ka pasur edhe me shumë pozita të lira të kategorisë së mesme drejtuese në institucionet e administratës shtetërore, por sistemimi sipas aktit kontestues në pozitën e lartpërmendur është bërë sipas diskrecionit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe nëse është ushtruar diskrecioni, mungon shpjegimi se pse është

ushtruar ai në mënyrën e dhënë si në vendim. Andaj, Kolegji vlerëson se si i tillë ky vendim është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të nenit 48 paragrafit të Ligjit 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “ *Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”, ashtu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konsiderohet i pa ligjshëm dhe për rrjedhojë i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kështu që, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoi se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. me Nr.1920/2025 të datës 14.10.2025, nuk ka respektuar dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lëndën e ankuesit ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, përkatësisht tek Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me qëllim që ky i fundit me rastin e shqyrtimit të kësaj procedure nga marrëdhënia e punës së ankuesit, të marrë për bazë pikëpamjet juridike të arsyetimit të këtij vendimi të Këshillit, dhe pas konstatimit në mënyrë të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike, përkatësisht shqyrtimit të të gjitha provave materiale, të nxjerr vendim meritore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë çështjen përkatëse si dhe në pajtim me dispozitat procedurale, ngase respektimi i dispozitave procedurale është njeri ndër parakushtet kryesore për nxjerrjen e një akti administrativ të drejtë dhe të ligjshëm.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1816/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Isuf Zejna;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.B